Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONMIK

PËR VITIN 2019

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZhE), në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Arvita Zyferi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Luljeta Sylaj udhëheqës i ekipit, Bahri Statovci dhe Mazllumshahe Sejfadini anëtarë, nën menaxhimin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit....5

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore....6

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli....8

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve....16


Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja....22

Shtojca II: Letër konfirmimi....25

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZhE) për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV). Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore të MZhE-së të prezantuara në Raportin Vjetor Financiar (RVF) për vitin 2019, që ndërlidhen me pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit dhe shpalosjet për këto pasqyra janë të plota dhe të sakta.

Menaxhimi financiar dhe kontrollet e brendshme në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, mirëpo kërkohet më tepër angazhim për të eliminuar mangësitë tek realizimi i pagesave dhe pasuritë.

Ministria i është përgjigjur pozitivisht rekomandimeve të vitit paraprak, ku është vërejtur një angazhim i shtuar në adresimin dhe monitorimin e tyre.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm[1]

Opinion i pamodifikuar
Më gjerësisht, shih kapitullin 1 të raportit.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Ministria është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë gjatë procesit të auditimit.

[1] Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të MZhE-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Ministria. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i MZhE-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet e brendshme të MZhE-së në përgjithësi janë zbatuar nga menaxhmenti dhe janë treguar efektive në parandalimin e parregullsive. Megjithatë, mos zbatimi me konsistencë i rregullave dhe obligimeve statutore, ka shkaktuar mangësi në menaxhimin e pagave dhe të pasurisë.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[2]	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**40,278,861**	**42,834,475**	**25,698,493**	**60**	**22,447,006**	**22,972,556**
Granti i Qeverisë – Buxheti	20,070,861	23,530,875	21,113,353	90	16,849,412	20,223,249
Financimet nga Huamarrja	11,208,000	11,208,000	3,638,048	32	5,597,594	2,749,307
Të hyrat nga AKP[3]	2,000,000	1,095,600	947,092	86	0	0
Klauzola e investimeve	7,000,000	7,000,000	0	0	0	0

Buxheti final i MZhE-së në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,555,614€. Ndryshimet buxhetore kanë ndodhur bazuar në vendimin e Qeverisë 02/115 të datës 17.12.2019, për kursime dhe ndarje. Detajet janë paraqitur në paragrafët vijues pas tabelës 2.

Në vitin 2019, ministria ka shpenzuar 60% të buxhetit final ose 25,698,493€, me një rënie prej 35% krahasuar me vitin 2018. Në shpenzimin e ulët të buxhetit kishte ndikuar shpenzimi i ulët i mjeteve

[2] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
[3] Agjencia Kosovare e Privatizimit

të fondit të huamarrjes, të cilat nuk kishin arritur të shpenzohen në bazë të planifikimeve. Mjetet nga fondi i huamarrjes ishin shpenzuar vetëm 32%. Përveç kësaj buxheti i paraparë për financimin e projekteve kapitale[4] nga klauzola e investimeve me vlerë 7mil.€, nuk është alokuar/ndarë për shpenzim tek ministria, për shkak se nuk janë nënshkruar Memorandumet e Mirëkuptimit për projektet.[5]

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**40,278,861**	**42,834,475**	**25,698,493**	**60**	**22,447,006**	**22,972,556**
Pagat dhe Mëditjet	1,260,112	1,277,879	1,277,879	100	1,293,195	1,116,910
Mallrat dhe Shërbimet	4,338,669	4,403,160	2,053,421	47	3,789,853	2,656,685
Shërbimet komunale	46,210	46,210	12,960	28	12,851	18,311
Subvencionet dhe Transferet	12,493,870	15,766,859	14,731,512	93	8,984,721	8,058,014
Investimet Kapitale	22,140,000	21,340,367	7,622,721	36	8,366,386	11,122,636

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje për dallim nga buxheti fillestar ishte rritur për 17,767€. Kjo rritje vjen si rezultat i vendimit të Qeverisë nr. 03/115 të datës 17.12.2019. Rritja ishte bërë për arsye se nevojiteshin mjete shtesë për të kompensuar rritjen e numrit të stafit politik në raport me planifikimin;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në total kishte rritje prej 64,491€. Kjo rritje ishte bërë në pajtim me neni 30.2 të LMFPP ku Ministri i Financave kishte aprovuar kërkesat e MZHE-së për transferet buxhetore në këtë kategori;

[4] Projektet që do të financoheshin përmes Klauzolës së investimeve janë: Ndërrimi i Gypave të Asbestit-Çimentos në qytetin e Gjakovës; Ndërtimi i Impiantit për trajtimin e Ujërave të Zeza-Ferizaj; Kanalizimi Fekal për 6 fshatra në Deçan; dhe Ujëmbledhësi për Ujë të Pijes në fshatin Verboc-Drenas.

[5] Marrëveshja Kornizë për Bashkëpunim me Qeverinë Hungareze (që është burimi i financimit për projektet në fjalë) është në proces të amendamentit dhe ende nuk është përfunduar ky proces.

- Tek subvencionet dhe transferet buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,272,989€. Rritja kishte ardhur përmes vendimit të Qeverisë nr. 03/115 të datës 17.12.2019 për kursime dhe ndarje buxhetore, ku ishin ndarë 3,502,989€ për mbështetjen e Ndërmarrjeve Publike[6]; ndërsa, zvogëlimi prej 230,000€ ishte bërë në pajtim me nenin 30.2 të LMFPP ku Ministri i Financave kishte aprovuar kërkesat e MZHE-së për transferet buxhetore nga kjo kategori në kategori tjera ekonomike;
- Buxheti fillestar krahasuar me buxhetin final për investime kapitale në total ishte zvogëluar për 799,633€. Lëvizjet buxhetore te kjo kategori ishin bërë si në vijim:
    - Me vendimin e Qeverisë nr.03/115 në emër të kursimeve ishin marrë 965,142€; dhe
    - Rritja prej 165,509€ ishte bërë në pajtim me nenin 30.2 të LMFPP ku Ministri i Financave kishte aprovuar kërkesat e MZHE-së për transferet buxhetore nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime dhe subvencione në këtë kategori.

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 1,277,879€, përderisa ishte shpenzuar në tërësi. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 181, ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 176. Kemi testuar 15 mostra për teste substanciale në vlerë 10,409€, si dhe tetë (8) mostra për teste të pajtueshmërisë në vlerë 5,688€.

[6] Pas vendimit të ministrit të MZhE mjetet i janë ndarë NP: KRU Mitrovica 828,929€; Posta e Kosovës 720,000€; Trepça 700,000€; Infrakos 400,000€; KRU Hidroregjioni Prizren 300,000€; Trainkos 300,000€; Ngrohtorja Gjakova 300,000€; KRU Hidromorava Gjilan 250,000€; KRM Pastërtia Ferizaj 150,000€ dhe KRM Uniteti Mitrovicë 144,060€.

Çështja B1 Mungesa e evidencave për vijueshmërinë në punë

Gjetja

Ligji 03/L-149 Për Shërbyesit civil të Republikës së Kosovës, neni 36 parasheh që: 'Orari i punës së nëpunësve civilë nuk do të tejkalojë dyzet (40) orë në javë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj' .Po ashtu rregullorja 05/2010 për orarin e punës, neni 7 parasheh që: " Gjatë orarit të punës të gjithë nëpunësit civil janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo nëpunës civil shënohet në librin e vijueshmërisë apo në regjistrin elektronik".

Vendimi i Qeverisë nr.06/39 i datës 22.07.2015, aprovon konkluzionet e dakorduara për zbatimin e të ashtuquajturës "Mbrojtja Civile". Në MZhE ishin caktuar të punojnë 18 ish pjesëtar të "Mbrojtjes Civile" të cilët ishin pajisur me akt emërime.

Ne kemi vërejtur se për 18 zyrtarët e lartcekur, ministria nuk ka dëshmi për ta konfirmuar prezencën e tyre në vendin e punës, apo raporte për punën e kryer gjatë vitit 2019, përderisa ministria kishte bërë pagesën e rregullt të pagave të tyre. Vlera financiare për shpenzimet e pagave për vitin 2019 për këta zyrtar ishte 92,708€. Kjo gjendje ishte e njëjtë edhe në vitin e kaluar dhe e njëjta ishte raportuar në raportin tonë të auditimit për vitin 2018.

Sipas MZhE kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së hapësirave të punës me ç'rast zyrtarët kanë mbetur të paangazhuar dhe pa vijuar punën.

Ndikimi

Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmive për vijueshmërinë në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të parregullta dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të sigurojë se bëhet monitorimi i rregullt i vijueshmërisë në punë për të gjithë punonjësit e ministrisë dhe në rastet e mos respektimit të orarit të punës të merren masa konkrete siç parashihen me kornizën e aplikueshme ligjore.

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe komunali ishte në vitin 2019 ishte 4,449,370€, prej tyre ishin shpenzuar 2,066,382€, apo 46% e këtij buxheti. Shpenzimet kishin të bëjë me shërbime kontraktuese, shpenzimet për material zyrtar, udhëtime zyrtare, për derivate, telefon, internet, etj. Kemi testuar 35 mostra për teste substanciale në vlerë 1,103,606€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë me vlerë 260,246€. Nuk kemi hasur ndonjë çështje materiale për të raportuar.

2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Në vitin 2019 buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 15,766,859€, prej tyre ishin shpenzuar 14,731,512€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencionimin e Ndërmarrjeve Publike (NP) për

projekte kapitale, me mbulimin e shpenzimeve operative të NP dhe subvencionime tjera. Pagesat janë bazuar në Marrëveshjet e Monitorimit dhe Kontrollit të nënshkruara me secilën NP përkatëse dhe me vlerën e specifikuar në Ligjin e Buxhetit për vitin 2019.

Kemi testuar 64 mostra për teste substanciale në vlerë 12,093,848 si dhe shtatë (7) mostra për teste të pajtueshmërisë me vlerë 4,008,986€.

Çështja A1 Pagesa nga kategoria ekonomike e gabuar

E gjetura

Neni 33 paragrafi 1 i Rregullës Financiare nr. 01/2013 MF- Shpenzimi i Parave Publike specifikon që organizatat buxhetore duhet të sigurojnë që të gjithë personat në marrëdhënie pune të paguhen përmes listës së pagave.

Me arritjen e moshës së pensionimit dhe përfundimin e marëdhënjes së punës, MZhE për dy zyrtarë nga kategoria subvencione dhe transfere kishte paguar nga një pagë përfshirë edhe kompenzimin për ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor. Pagesa në tolal ishte 2,256€. Pagesat e tilla duhet të paguhen nga kategoria paga dhe mëditje. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së buxhetit në kategorinë paga dhe mëditje.

Ndikimi

Pagesa e pagave nga kategoria subvencione dhe transfere, paraqet një pasqyrë jo të drejtë të shpenzimit të buxhetit, duke ndikuar në mbivlerësimin e shpenzimeve në kategorinë subvencione e transfere dhe nënvlerësimin e shpenzimeve në kategorinë paga dhe mëditje.

Rekomandimi A1

Menaxhmenti i ministrisë të siguroj se bëhet një planifikim i duhur i buxhetit për secilën kategori bazuar në nevojat reale të ministrisë dhe të bëhen pagesat nga kategoria adekuate.

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 21,340,367€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 7,622,721€. Ato kanë të bëjnë me zbatimin e masave për efiçencën e energjisë në ndërtesat publike e objektet arsimore, transfere kapitale për programin mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zona rurale si dhe për programin e zbatimit të ekonomisë digjitale. Kemi testuar 25 mostra për teste substanciale në vlerë 7,429,839€, si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 Vonesa në realizimin e projektit

Gjetja	MZhE në kontratën e nënshkruar me 21.08.2019 në vlerë 309,342€, për projektin "Implementimi i masave të efiqiencës së energjisë në objektet arsimore", kishte specifikuar që ky projekt të përfundojë 90 ditë pune pas nënshkrimit të kontratës. Projekti ishte bashkëfinancim me Komunën e Gjakovës e cila kishte marrë pjesë me 29,000€. Megjithatë, deri me 04.06.2020, sa ne ishim në terren ky projekt nuk ishte përfunduar. Punimet kishin mbetur të papërfunduara për shkak të pozicionit me vlerë 40,150€, të cilin komuna kërkon ta ndërrojë nga "fasada fundermax" në "tullë" për shkak të pamjes arkitektonike të objektit/shkollës. Aktualisht ministria nuk po gjen zgjidhje në këtë çështje. Kontrata ishte përcjellë edhe me probleme tjera ku në proces të punës është ndërruar kryesuesi i komisionit të mbikëqyrjes së projektit.
Ndikimi	Mosrealizimi i projekteve sipas planit dinamik ndikon në mos-realizimin e synimeve të planifikuara të ministrisë.
Rekomandimi A2	Ministri duhet të ndërmarrë masat e duhura që në koordinim me Komunën Gjakovës të zgjidhë problemin që e ka shkaktuar vonesën e realizimit të projektit dhe të sigurojë realizimin e plotë të punëve në afat sa më optimal.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 20,275,325€, pasurive jokapitale është 27,490€, si dhe e stoqeve 35,695€. Kemi testuar 30 mostra për teste substanciale në vlerë 7,324,051, si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 Mangësi në menaxhimin e pasurisë

Neni 6 i Rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore specifikon se çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Në regjistrin e pasurisë kapitale në vitet e mëhershme ishin regjistruar 15 asete me vlerë neto prej 512,372€, të cilat ishin mallra dhe shërbime. Pagesat e regjistruara gabimisht kishin të bënin me studime gjelologjike/gjeokimike, vlerësime të potencialit të energjisë, studime, strategji dhe prurje vjetore inerte. Kjo bën që pasuritë kapitale të jenë të mbivlerësuara. Kjo çështje ishte ngritur në raportin e auditimit tonë për vitin 2018.

Edhe pse ishte kërkuar nga Thesari fshirja e pasurive të cilat janë regjistruar si mallra dhe shërbime nga regjistri i SIMFK ato ende nuk janë fshirë.

Ndikimi Mos azhurnimi i regjistrit të pasurisë respektivisht mos-fshirja e mallrave dhe shërbimeve nga regjistri i pasurive kapitale, ka ndikuar në mbivlerësimin pasurive duke krijuar një pamje jo të saktë të vlerës së pasurisë për lexuesit e RVF.

Rekomandimi B2 Ministri duhet që të siguroj funksionimin sistematik të kontrollit lidhur me azhurnimin në kohë reale të regjistrit të pasurisë kapitale.

2.3 Detyrimet e papaguara dhe kontingjente

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, të prezantuara në RVF të e organizatës ishte 15,485€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

Për qëllime të testimit substancial, ne kemi testuar pesë (5) mostra në vlerë totale prej 9,880€, të cilat ishin paguar në fillim të vitit 2020. Po ashtu ne kemi verifikuar se MZhE kishte raportuar në Ministrinë e Financave në baza të rregullta mujore për obligimet e papaguara.

Obligimet e papaguara kishin të bënin me dreka zyrtare, shpenzime kontraktuese tjera, shpenzime të internetit dhe telefonisë, karburante dhe sigurim të objektit. Pjesa dërmuese e faturave apo 87% janë pranuar në fund të muajit dhjetor dhe pas përmbylljes së Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiare të Kosovës (SIMFK). Këto ishin arsyet pse këto fatura nuk janë proceduar për pagesë në vitin 2019.

Derisa detyrimet kontingjente, të prezantuara në pasqyrat financiare të ministrisë për vitin 2019 janë 3,189,703€ të cilat kanë të bëjnë me dy procedura përmbarimore[7] për të cilat ende nuk janë përfunduar procedurat ligjore.

MZhE në fund të vitit 2019 ka paraqitur detyrimet kontraktuale mbi 11 milionë euro. Këto detyrime kanë të bëjnë me kontrata të nënshkruara gjatë vitit aktual dhe paraprak për Investime Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime.

2.4 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një zyrtarë - Drejtori i NjAB-së. NJAB, ka përgatitur Planin strategjik (2018-2020) dhe Planin vjetor të cilët ishin aprovuar nga menaxhmenti i ministrisë. Në planin vjetor ishin planifikuar dhe realizuar katër auditime[8], të cilat mbulojnë vitin

[7] Kërkesë për përmbarim nga Ndërmarrja Publike Qendrore Posta e Kosovës Sh.A. rr "28 Nëntori" nga MZhE me vlerë 3,188,729€ dhe propozimi për përmbarim ndaj SIGKOS me vlerë 974€.

[8] "Sistemi i menaxhimit të përgjithshëm në Departamentin e Minierave viti 2019", Sistemi i menaxhimit- "Projekti i Kosovës për efiqinencë të Energjisë Elektrike të Ripërtrishme", viti 2019, Lidhja e marrëdhënies kontraktuale për tenderin "Krijimi i qendrave kreative për shkollat e mesme ë Kosovës" dhe Pozita emërimi dhe llogaridhënia e ZKF.

2019. Fushëveprim kishin, sistemin e menaxhimit të departamentit të minierave, energjisë si dhe menaxhimin e investimeve kapitale.

NJAB, kishte raportuar në baza të rregullta edhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB). Puna e NJAB-it është mbikëqyrur nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm, i cili kishte mbajtur pesë takime ku ishin diskutuar sfidat me të cilat përballet NJAB-ja.

Çështja B3 Ekzistojnë disa dobësi tek NjAB

Gjetja Sipas Rregullores QRK-nr. 01/2019, për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 pika 1,1 përcakton që secila organizatë me buxhet mbi 7 milionë euro duhet të ketë tre auditorë të brendshëm. Po ashtu neni 10 paragrafi 1.2 thekson se planet strategjike dhe vjetore të auditimit duhet të dorëzohen më së largu deri me 31 dhjetor të vitit fiskal. Bazuar në këtë:

Ministria aktualisht ka vetëm një Auditorë dhe atë në cilësinë e Ushtruesit të Detyres të Drejtorit të NJAB-së, edhe pse buxheti i MZhE është mbi 40 mil.€ dhe sipas kësaj duhet të ketë tre auditorë. Po ashtu plani vjetor i NJAB-së ishte hartuar dhe miratuar me vonesë, në muajin maj. Kjo kishte ndodhur për shkak të ndërrimeve në udhëheqjen e kësaj njësie.

Ndikimi Mos kompletimi i NJAB-së dhe mos hartimi me kohë i planit i pamundëson menaxhmentit posedimin me kohë të informatave rreth përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit në relacion me kryerjen e detyrave dhe arritjen e objektivave të ministrisë.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të ndërmarr veprimet adekuate për të siguruar burimet e mjaftueshme njerëzore për kompletimin e NJAB-së si dhe të aprovoj me kohë planet vjetore dhe strategjike të NJAB.

Çështja A3 Zbatimi i rekomandimeve të NJAB-së jo në nivelin e kënaqshëm

Gjetja

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit për sektorin publik, neni 7, paragrafi 1.7 thekson se Komiteti i auditimit shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.

Ne kemi vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB dhe kemi vërejtur një zbatim të ultë të rekomandimeve. Nga 22 rekomandime të dhëna, 7 ishin zbatuar ndërsa 15 rekomandime nuk ishin zbatuar.

Shkaku i mos zbatimit të rekomandimeve është mungesa e një procesi formal të monitorimit të tyre nga menaxhmenti.

Ndikimi

Mungesa e gatishmërisë për të zbatuar plotësisht rekomandimet e NJAB-së ndikon në mos përmirësimin e proceseve të cilat më pas ndikojnë në mos arritjen e objektivave të Ministrisë.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm përcillen me një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e tyre.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 të MZhE-së ka rezultuar me 14 rekomandime. MZhE kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Gjithashtu, ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi Zbatimin e Rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars), sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për Zbatimin e Auditimit dhe Planeve të Veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, nëntë (9) rekomandime janë zbatuar, tri rekomandime janë të pazbatuara, dhe dy janë të mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4 (Tabela e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
B1	PFV	Ministri duhet të ndërmerr veprime për t'i forcuar kontrollet parandaluese në mënyrë që të shmangen rastet për Theksim të Çështjes në Opinion. Ne rekomandojmë që qysh në fazën e planifikimeve buxhetore, projektet të buxhetohen sipas kategorive ekonomike dhe klasifikimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë nëpër kodet adekuate.	Menaxhmenti i MZhE kishte ndërmarr hapat e nevojshëm duke klasifikuar saktë shpenzimet. Në vitin 2019 kemi hasur një keq klasifikim te subvencionet i cili nuk ishte material.	Rekomandim i mbyllur.
C1	PVF	Ministri duhet të siguroj funksionimin adekuat dhe sistematik të kontrollit lidhur me plotësinë e regjistrave të pasurisë duke siguruar se Pasqyrat Financiare Vjetore do t'i nënshtrohen rishikimit dhe vlerësimit rigoroz nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, para se deklarata të nënshkruhet dhe PFV të dorëzohen në Ministrin e Financave.	MZhE edhe pse kishe bërë progres në regjistrimin e pasurive ajo ende nuk ka arritur ta bëjë një regjistër të plotë të pasurive. Pasuritë e identifikuar si mallra dhe shërbime të regjistruara në regjistrin e pasurive ende nuk i ka fshirë.	Rekomandim i pazbatuar

A1	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mosvijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e pagave të tyre të parregullta. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.	Menaxhmenti i MZhE nuk ka marrë asnjë hap në drejtim të zbatimit të këtij rekomandimi.	Rekomandim i pazbatuar
A2	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të veprojë në pajtim me obligimet ndaj kontratave të AQP-së, me qëllim të ekonomizimit të shpenzimeve dhe arritjes së vlerës për para.	Në këtë vit nuk ka pasur furnizime me artikuj të tillë.	Rekomandim i zbatuar
A3	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të siguroj respektimin e rregullave në fuqi që shpenzimet për udhëtime zyrtare të bëhen vetëm për qëllime zyrtare dhe për të gjitha shpenzimet e pa rregullta, të bëhet kthimi i mjeteve në buxhetin e ministrisë.	Mjetet ishin kthyer në buxhetin e Kosovës	Rekomandim i zbatuar
A4	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të siguroj se zyrtarët e prokurimit janë plotësisht përgjegjës dhe kompetent në punën e tyre, dhe se të gjitha blerjet bëhen në pajtim me procedurat, duke synuar çmime sa më konkurruese.	Gjatë testimit të mostrave nuk kemi hasur shpenzime të bëra jashtë kontratës bazë.	Rekomandim i zbatuar
A5	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se monitorimi i marrëveshjes së arritur me Trepçën zbatohet në të gjitha dispozitat, dhe se asnjë transfer nuk do të bëhet para se të konfirmohet edhe me raportin e auditimit të brendshëm[3].	Ministria nuk kishte bërë pagesa pa pranimin e raportit të Auditimit të Brendshëm	Rekomandim i zbatuar

B2	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet siguroj se me rastin e planifikimit të kërkesave buxhetore të përfshihet edhe kërkesa për fonde buxhetore për angazhimin e këshilltarëve ose të ndonjë kompanie të këshillimit për të ndihmuar procesin e vlerësimit.	Ministria ka kontraktuar kompaninë e cila kishte bërë vlerësimin e efektshmërisë së drejtorëve të NP.	Rekomandim i zbatuar
B3	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se në të gjitha marrëveshjet janë vendosur kritere të qarta rreth procesit të monitorimit dhe raportimit, dhe se të njëjtat kritere zbatohen në mënyrë rigoroze me rastin e transfereve të subvencioneve tek ndërmarrjet publike.	Për secilën pagesë ishin pranuar dëshmitë mbështetëse dhe ishte raportuar për subvencionin e dhënë.	Rekomandim i zbatuar
A6	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj që para nënshkrimit të kontratave, të zotohen fondet e duhura për mbulimin e obligimeve kontraktuese.	Për secilën kontratë është nënshkruar deklarata e disponueshmërisë së mjeteve dhe zotimet.	Rekomandim i zbatuar
A7	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet që të siguroj se do të nxirret udhëzim i brendshëm dhe të emërojë zyrtar kompetent në komisionet për inventarizim në mënyrë që nga procesi i inventarizimit të konfirmohet ekzistenca fizike e pasurive dhe saktësia, dhe gjendja përfundimtare pasurive jo financiare të raportohet në PFV.	MZhE ka krijuar komisionin për inventarizimin e pasurisë si dhe udhëzuesin për menaxhimin e pasurisë.	Rekomandim i zbatuar

A8	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të siguroj që pozitën e zyrtarit për menaxhimin e pasurisë të mbulohet nga zyrtarët kompetent dhe të përgjegjshëm, dhe të siguroj trajnime adekuate profesionale në mënyrë që regjistrat e pasurisë të menaxhohen në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.	MZhE ka fshirë nga regjistri i e-pasurisë pasuritë kapitale dhe pasuritë e reja të blera në vitin 2019 janë regjistruar saktë.	Rekomandim i zbatuar
B4	Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të ndërmarrë veprime për siguruar burimet e mjaftueshme njerëzore për funksionimin e duhur dhe efektiv të auditimit të brendshëm, si dhe të aprovoj me kohë planet vjetore të punës për NJAB.	Me gjithë iniciativat menaxhmenti nuk kishte arritur të adresojë tërësisht këtë rekomandim.	Rekomandim i pazbatuar
B5	Raportimi menaxherial.	Ministri duhet të siguroj se gjatë raportimeve të rregullta të mbahen procesverbale të detajuara dhe të dëshmohen veprimet e ndërmarra për reduktimin e rreziqeve para procesit të vendimmarrjes. Përveç tjerash, zgjidhja e problemit të pajisjes SEM duhet trajtuar me prioritet.	Pajisja SEM është vë në funksion.	Rekomandim i mbyllur
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
B1	Mungesa e evidencave për vijueshmërinë në punë	Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mosvijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e pagave të tyre të parregullta. Për shkak të ndjeshmërisë së këtij problemi, ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.		
A1	Pagesa nga kategoria ekonomike e gabuar	Menaxhmenti i ministrisë të siguroj se bëhet një planifikim i duhur i buxhetit për secilën kategori bazuar në nevojat reale të ministrisë dhe të bëhen pagesat nga kodi adekuat.		

A2	Vonesa në realizimin e projektit	Ministri duhet të ndërmarrë masat e duhura që në koordinim me Komunën Gjakovës të zgjidhë problemin që e ka shkaktuar vonesën e realizimit të projektit dhe të sigurojë realizimin e plotë të punëve në afat sa më optimal.
B2	Mangësi në menaxhimin e pasurisë	Ministri duhet që të siguroj funksionimin sistematik të kontrollit lidhur me azhurnimin në kohë reale të regjistrit të pasurisë kapitale.
B3	Ekzistojnë disa dobësi tek NjAB	Ministri duhet të ndërmarr veprimet adekuate për të siguruar burimet e mjaftueshme njerëzore për kompletimin e NJAB-së si dhe të aprovoj me kohë planet vjetore dhe strategjike të NJAB.
A3	Zbatimi i rekomandimeve të NJAB-së jo në nivelin e kënaqshëm	Ministri duhet të siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm përcillen me një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e tyre.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vada-Government
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine/Ministry of Economy and Environment

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");

- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe

- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Mentor Sylmeta.....

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit,

Data: 07.07.2020, Prishtinë,